



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 8

Tiranë – E premte, 1 shkurt 2019

## PËRMBAJTJA

|                                                                                           | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dekret i Presidentit<br>nr. 11065, datë 24.1.2019                                         | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 237                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Udhëzim i ministrit të<br>Infrastrukturës dhe Energjisë<br>nr. 1, datë 15.1.2019          | Për disa shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2012, “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre”, i ndryshuar..... 237                                                                                                                                                                                                                                               |
| Urdhër i zëvendësministrit të<br>Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural<br>nr. 18, datë 11.1.2019 | Për një shtesë në aneksin II, “Mish i freskët”, pjesa 1, të urdhrit të ministrit nr. 328, datë 22.11.2011, për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve”, të ndryshuar ..... 239 |
| Urdhër i ministrit të Arsimit,<br>Sportit dhe Rinisë<br>nr. 44, datë 24.1.2019            | Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë..... 239                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Vendim i Entit Rregullator të<br>Energjisë nr. 2, datë 17.1.2019                          | Mbi fillimin e procedurës për miratim të “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”..... 240                                                        |
| Vendim i Entit Rregullator të<br>Energjisë nr. 3, datë 17.1.2019                          | Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë MTC Energy sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeyen Bank sh.a..... 241                                                                                                                                                                                                      |

|                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |     |
|---------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 4, datë 17.1.2019 | Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 242 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 5, datë 17.1.2019 | Mbi licencimin e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 243 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 6, datë 17.1.2019 | Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “SA’GA Mat” sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 247, seria PV14K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Germani 1” me kapacitet të instaluar 1200 kw, “Germani 2” me kapacitet të instaluar 1680 kw, “Germani 3” me kapacitet të instaluar 1290 kw, “Germani 4” me kapacitet të instaluar 810 kw, me kapacitet total të instaluar 4980 kw..... | 244 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 7, datë 17.1.2019 | Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2018.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | 246 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 8, datë 17.1.2019 | Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 248 |

**DEKRET****Nr. 11065, datë 24.1.2019****PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Shkelqim Bajram Logja
2. Ergis Bledar Xhakaj
3. Klajd Ilir Agolli
4. Daniel Ilir Draçini
5. Tano Vojislav Mikulić
6. Alban Xhemali Kaloshi
7. Xhemali Dan (Don) Kaloshi
8. Gledis Bledar Xhakaj
9. Alba Benard Kellner (Kabashi)
10. Dejan Vojo Brajović (Bercana)
11. Anisa Stiljan Zhidro (Foto)
12. Alexandros Kostantinos Zhidro
13. Kristina Kostantinos Zhidro
14. Flutur Jakup Zeka
15. Dorian Abaz Kameraj
16. Bora Nexhmi Bushati
17. Valon Mevlud Kodhelaj
18. Elida Mwrzuk Wagner (Mandija)
19. Asllan Kamber Asllani
20. Mehmet Ylli Bineri
21. Entela Edmond Schwiemann (Hasani)
22. Elisa Edmond Toro
23. Sanja Dushan Matanoviq
24. Kastriot Bozho Brajoviq (Brojaj)
25. Zoranka Bozho Ajković (Brojaj/Brajoviq)
26. Oriola Ëngjëll Kadilli
27. Majlinda Qerem Çullhaj
28. Veriana Agim Azizi (Bejta)
29. Borana Veip Lushaj
30. Luar Roland Arani

31. Mimoza Preng Gjera

32. Besim Mustafa Cani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

**UDHËZIM****Nr. 1, datë 15.1.2019**

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN  
NR. 1, DATË 18.1.2012, “PËR  
DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE  
TË REGJISTRIMIT TË MJETEVE  
RRUGORE ME MOTOR DHE  
RIMORKIOVE TË TYRE”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 252 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 10.10.2012, pika 4, seksioni VIII, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

**UDHËZON:****Neni 1**

Në nenin 21 të emërtuar “Heqja e përhershme e mjeteve nga qarkullimi”, në pikën 4 shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) “Certifikatën e shkatërrimit” të lëshuar nga operatorët ekonomikë në përputhje me parashtrimet e akteve ligjore e nënligjore për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës. Format i certifikatës së shkatërrimit, është sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjijnuri**



## ÇERTIFIKATË SHKATËRRIMI

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Mbështetur në VKM Nr.705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës, dhe Udhëzimin Nr.1, datë 18.01.2012, të ndryshuar të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, lëshohet kjo çertifikatë shkatërrimi, si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik<sup>i</sup>

1.1 Emri i Operatorit/Subjekti \_\_\_\_\_

1.2 Adresa/Kontakt/Tel: \_\_\_\_\_

1.3 NUIS/NIPT: \_\_\_\_\_

## 2. Liçencat dhe Lejet

2.1 Liçence Kategoria \_\_\_\_\_ Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

E vlefshme deri më \_\_\_\_\_

2.2 Leje Mjedisore, Kodi \_\_\_\_\_ ; PN \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

E vlefshme deri më \_\_\_\_\_

## 3. Të dhënat e automjetit

3.1 Targa: \_\_\_\_\_

3.2 Nr. Lejes së qarkullimit: \_\_\_\_\_

3.3 Marka: \_\_\_\_\_

3.4 Tipi: \_\_\_\_\_

3.5 Lloji: \_\_\_\_\_

3.6 Nr. Identifikimit/Shasise: \_\_\_\_\_

3.7 Ngjyra: \_\_\_\_\_

3.8 Viti i prodhimit \_\_\_\_\_

## 4. Zotëruesi i mjetit

## 5.1. Zotëruesi i mjetit

a) Emri/ Atësia/Mbiemri \_\_\_\_\_

b) Adresa: \_\_\_\_\_

c) Nr. Dokumentit  
Identifikimit \_\_\_\_\_

d) Shtetësia: \_\_\_\_\_

## 5.2. Person Fizik/ Juridik

a) Emri i Subjektit: \_\_\_\_\_

b) NUIS: \_\_\_\_\_

b) Adresa: \_\_\_\_\_

c) Autorizimi përfaqësimi lëshuar nga subjekti

Nr. \_\_\_\_ Prot, Datë \_\_\_\_

d) Nr. Dokumentit identifikimit \_\_\_\_\_

e) Shtetësia : \_\_\_\_\_

Kjo çertifikatë është e vlefshme për kryerjen e procedurave për heqjen e përhershme nga qarkullimi, sipas pikes 4 neni 21 i Udhëzimit Nr.1, datë 18.01.2012, i ndryshuar .

OPERATORI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR

ZOTËRUESI I MJETIT

<sup>i</sup> Operator ekonomik, sipas përcaktimit në Kreun III, pika 13, VKM Nr.705, datë 10.10.2012

**URDHËR**

Nr. 18, datë 11.1.2019

**PËR NJË SHITESË NË ANEKSIN II,  
“MISH I FRESKËT”, PJESA 1, TË  
URDHRIT TË MINISTRIT NR. 328, DATË  
22.11.2011, PËR MIRATIMIN E  
RREGULLORES “MBI PËRCAKTIMIN E  
KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR  
CERTIFIKIMIN VETERINAR TË DISA  
LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË  
FRESKËT TË TYRE, TË CILAT HYJNË  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA  
SHTETE TË CAKTUARA, SI DHE NGA  
TERRITORE TË TJERA NË  
ADMINISTRIM TË KËTYRE  
SHTETEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 18, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Në urdhrin e ministrit nr. 328, datë 22.11.2011, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve’”, të ndryshuar, në aneksin II, “Mish i freskët”, pjesa 1, në pikën 2, “Lista e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, territoreve dhe pjesëve të tyre”, në rreshtin TR-Turqi, me kod territori TR-0, në kolonën 4 shtohet fjala “SUW”, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI I BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL  
**Ermira Gjeçi**

**SHTOJCË****2. Lista e vendeve jashtë Bashkimit Evropian, territoreve dhe pjesëve të tyre (1)**

| Kodi ISO dhe emri i vendit eksportues | Kodi i territorit | Përshkrimi i vendit eksportues, territorit ose pjesës së tij | Certifikata veterinare |      | Kushte të veçanta | Data e mbylljes (2) | Data e hapjes (3) |
|---------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------------------------|------------------------|------|-------------------|---------------------|-------------------|
|                                       |                   |                                                              | Modeli                 | G SH |                   |                     |                   |
| 1                                     | 2                 | 3                                                            | 4                      | 5    | 6                 | 7                   | 8                 |
| TR – Turqi                            | TR-0              | I gjithë vendi                                               | SUW                    |      |                   |                     |                   |

**URDHËR**

Nr. 44, datë 24.1.2019

**PËR DELEGIMIN DHE DISA  
RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR  
TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në

emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia, nëpërmjet autorizimit të lëshuar.



5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre, e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, propozimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar me vendimet përkatëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, qendrore dhe territoriale, të caktojnë një person përgjegjës që do të jetë pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, me Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

9. Ngarkohet Sektori i Arkiv/Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

10. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Arkiv/Protokollit, institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË  
Besa Shahini

Nr. prot. Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019

### AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN  
ADMINISTRATIVE/ CIVILE ME PALË:

Paditës: .....

E paditur: .....

Objekti: .....

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe të urdhrit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 467, datë 2.10.2017, “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, i ndryshuar,

### VENDOSA:

Autorizimin e z./znj. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_, për të përfaqësuar Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar ankimin / rekursin në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes administrative/civile me objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit (në gjykatën kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes përkatëse).

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
Oltjon Muzaka

### VENDIM

Nr. 2, datë 17.1.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
MIRATIM TË “PROPOZIMIT TË TË  
GJITHA OST-VE PËR NJË  
METODOLOGJI TË OFRIMIT TË  
DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE  
NGARKESËS NË PËRPUTHJE ME  
NENIN 16 TË RREGULLORES SË  
KOMISIONIT TË BASHKIMIT  
EVROPIAN (BE) 2015/1222, TË DATËS 24  
KORRIK 2015 PËR KRIJIMIN E NJË  
UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E  
KAPACITETEVE DHE MENAXHIMIN E  
KONGJESTIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 7, nenit 56 dhe nenit 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e



energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 75 të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, nenit 26 të “Rregullave për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtare, me të drejta të plota, e ENTSO-E, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 8383 prot., datë 11.12.2018, ka përcjellë në ERE, për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

- Dokumenti vjen në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018 me objekt “Propozimi i gjitha OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë” dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë së Modelit të Përbashkët të Rrjetit.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar me ligjin nr. 8/2018, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për të

krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë me qëllim alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjitha OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen, gjithashtu, që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit në bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 3, datë 17.1.2019

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË MTC ENERGY SHPK, PËR  
VENDOSJE HIPOTEKE DHE BARRË  
MBI ASETET E SHOQËRISË “M.T.C.  
ENERGY” SHPK, PËR EFEKT TË  
RISTRUKTURIMIT TË KREDISË NË  
FAVOR TË RAFFEISEN BANK SHA**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 44, pika 1,

Faqe | 241



të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 1.3 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 11 të “Rregullore të procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me transferimin e aseteve të shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për lënie peng në favor të Raffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE në datën 26.12.2018 shoqëria “M.T.C Energy” sh.p.k., ka depozituar në ERE, kërkesën për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C. ENERGY” sh.p.k., për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeisen Bank sh.a. dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29 prot., datë 10.1.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacion plotësues për aplikimin e tij. Po ashtu edhe Raiffeisen Bank sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29/1 prot., datë 10.1.2019, ka përcjellë deklaratën nr. 614, datë 8.1.2019 dhe atë nr. 615, datë 8.1.2019, në funksion të këtij aplikimi.

- Kontrata e kredisë bankare nr. 4887 rep, nr. 2475 kol, datë 7.11.2016, që ndryshon kontratën nr. 4085 rep., nr. 1778 kol, datë 28.9.2012, e paraqitur nga subjekti në ERE, nuk parashikon barrësim apo lënie hipoteke të aseteve të të licencuarit, por vetëm ndryshimin e monedhës së përdorimit të linjës së kredisë dhe normës së interesit dhe dispozita të tjera që nuk shpreh për asetet e të licencuarit.

- ERE në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve fikse nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të ERE-s, shprehet vetëm për transferim të licencës ose të aseteve nga të licencuarit dhe jo për ristrukturim kredie (kolateral financiar). Si e tillë nuk është në kompetencën e ERE shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k., për efekt të ristrukturimit të kredisë në favor të Raffeisen Bank sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 4, datë 17.1.2019

#### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “KESH” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe neneve 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “KESH” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 769 prot., datë



7.12.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

- Në aplikimin e KESH sh.a. është konstatuar mungesë dokumentacioni, dhe ERE me shkresën nr. 769/1 prot., datë 17.12.2018, drejtuar KESH sh.a., ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit.

- Në vijim të sa më sipër, KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 769/2, datë 27.12.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacion plotësues për aplikimin e tij.

- Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim. neni 9, pika 1. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”. Plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3. Plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.

- Neni 9, pika 4.7.1, germat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), germën “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca); nenin 9, pika 4.7, germa “e” (Sistemi IT); germa “P” (lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës), do t’i kërkohet shoqërisë KESH sh.a., plotësimi brenda afateve të përcaktuara në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 5, datë 17.1.2019

#### MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SETA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 755 prot., datë 26.11.2018, ka aplikuar për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 257, datë 17.12.2018, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 55/71 prot., datë 17.12.2018, u bë njoftimi në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 755/1 prot., datë 20.12.2018, iu dërgua subjektit njoftim për vendimin përkatës.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe



afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Seta” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 6, datë 17.1.2019

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SA’GA MAT” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 247, SERIA PV14K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 92, DATË 16.10.2014, PËR PRODHIMIN E ENERGIJËS ELEKTRIKE NGA HEC-et: “GERMANI 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1200 kw, “GERMANI 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1680 kw, “GERMANI 3” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1290 kw, “GERMANI 4” ME KAPACITET TË INSTALUAR 810 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4980 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e përparësuar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për modifikimin e licencës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., nr. 247, seria PV14K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Germani 1”, me kapacitet të instaluar 1200 kw, “Germani 2”, me kapacitet të instaluar 1680 kw, “Germani 3”, me kapacitet të instaluar 1290 kw, “Germani 4”, me kapacitet të instaluar 810 kw, me kapacitet total të instaluar 4980 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 27.9.2018, ka vendosur fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., nr. 247, seria PV14K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 92, datë 6.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Germani 1”, me kapacitet



të instaluar 1000 kw; “Germani 2”, me kapacitet të instaluar 1300 kw; “Germani 3” me kapacitet të instaluar 850 kw; “Germani 4”, me kapacitet të instaluar 500 kw.

- Në vijim të vendimarrjes sipërcituar, ERE me shkresën nr. 55/58 prot., datë 28.9.2018, ka bërë publikimin në media lidhur me fillimin e procedurës për modifikimin e kësaj licence dhe mbas përfundimit të afatit, nuk ka pasur palë të interesuara për ndryshimet e kërkuara nga subjekti për modifikimin e licencës.

- ERE me shkresën nr. 567/2, datë 28.9.2018, ka njoftuar subjektin në lidhje me vendimarrjen e Bordit dhe po me këtë shkresë, bazuar në nenin 11, pikat 1 dhe 2, nenit 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ka bërë me dije mungesën e konstatuar të dokumentacionit të aplikimit, si: leja e rinovuar për përdorimin e ujit; leja e rinovuar mjedisore; miratimi i pikës së lidhjes nga OST sh.a., pas miratimit të ndryshimit të projektit për ndërtimin e hidrocentraleve “Germani 1” “Germani 2”.

- Shoqëria “SA’GA MAT” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me Nr. 567/1 Prot., datë 26.9.2018, ka depozituar plotësim dokumentacioni në vijim të aplikimit të tij për modifikimin e licencës i cili ka të bëjë me Marrëveshjen nr. 24 prot., datë 20.9.2018, “Për lidhjen me rrjetin e transmetimit të HEC-eve ‘Germani 1’ dhe ‘Germani 2’”, e cila është një marrëveshje me kohë të pacaktuar dhe ka për qëllim të përcaktojë termat dhe kushtet për lidhjen me rrjetin e transmetimit të HEC-it “Germani 1” dhe “Germani 2”, me kapacitet të instaluar 6.4 mw, në zbarat 10 kV të nënstacionit 220/110/10kV Koms (Burrel).

- Po ashtu në këtë korrespondencë ky subjekt në bazë të neneve 8, pika 4; 10, pikat 4 dhe 10, pika 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ka kërkuar shtyrjen e afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, deri në 30 ditë punë, për plotësimin e dokumentacionit të rifreskuar që ka të bëjë me lejen e përdorimit të ujit dhe lejen mjedisore, të lëshuara nga organet përkatëse. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, me informacionin nr. 76/6 prot., datë 2.10.2018, i propozoi/rekomandoi Bordit të ERE-s, shtyrjen e

vendimarrjes finale, lidhur me aplikimin e shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 247, seria PV14K, me 30 ditë pune nga data 19.12.2018.

- Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, pranoi kërkesën për shtyrjen e afatit të vendimarrjes finale në lidhje me këtë modifikim deri në datën 30.1.2019.

- ERE, me shkresën nr. 567/3 prot., datë 16.10.2018, ka njoftuar subjektin për pranimin e kërkesës nga Bordi i ERE-s dhe, gjithashtu, ka bërë me dije subjektin se duhet të depozitojë në ERE lejen e rifreskuar për përdorimin e ujit, si dhe lejen mjedisore, pas ndryshimit të projektit për ndërtimin e HEC-eve “Germani 1” dhe “Germani 2”, brenda datës 30.1.2019, në mënyrë që ERE të vijojë me mbylljen e kësaj procedure.

- Në vijim të sa më sipër, subjekti “SA’GAMAT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567/5 prot., datë 13.12.2018, ka paraqitur plotësim dokumentacioni në lidhje me lejen e përdorimit të ujit, vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Mat me nr. 2, datë 22.11.2018, “Për miratimin e lejes për përdorim burimi ujor, për prodhim hidroenergjie, subjektit ‘SA’GA MAT’ sh.p.k., për HEC-et ‘Germani 1’ dhe ‘Germani 2’, me vendndodhje: Përroi i Zallit të Germanit, degë e lumit Mat, në Njësinë Administrative Koms, Bashkia Mat, Qarku Dibër”.

- Po ashtu subjekti me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567/6 prot., datë 21.12.2018, ka paraqitur plotësim dokumentacioni sa i përket lejes mjedisore. Subjekti ka përcjellë në ERE shkresën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr. 2819/3 prot, datë 18.12.2018, drejtuar subjektit “SA’GA MAT” sh.p.k., në të cilën citohet se: “...duke qenë se subjekti ka marrë të gjitha lejet dhe licencat përkatëse për zhvillimin e këtij aktiviteti dhe punimet e ndërtimit janë në përfundim, bëjmë me dije se projekti nuk është e nevojshme t’i nënshtrohet nga e para procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.”.

- Për shkak të ndryshimeve që ka prodhuar kontrata e re shtesë e koncesionit e vitit 2017:

- Ka ndryshuar kapacitetin e instaluar e HEC-eve të dhëna me koncesion më herët e për të cilët ERE është shprehur me vendim, për licencimin e subjektit “SA’GA MAT” sh.p.k.

- Është reduktuar numri i HEC-eve nga 5 (pesë) në 2 (dy) përkatësisht “Germani 1” me kapacitet të



instaluar 4,800 kw, dhe “Germani 2”, me kapacitet të instaluar 1,500 kw.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 247, seria PV14K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Germani 1”, me kapacitet të instaluar 1200 kw, “Germani 2” me kapacitet të instaluar 1680 kw “Germani 3”, me kapacitet të instaluar 1290 kw “Germani 4” me kapacitet të instaluar 810 kw, me kapacitet total të instaluar 4980 kw, për një afat 30-vjeçar, në përputhje me ndryshimet e reflektuara në kontratën shtesë të koncesionit nr. 618 rep dhe nr. 203 kol, datë 13.6.2017, si më poshtë:

- Kudo ku shprehet hidrocentralet “Germani 1”, “Germani 2”, “Germani 3”, “Germani 4”, zëvendësohet me hidrocentralet “Germani 1” me kapacitet të instaluar 4,800 kw, dhe “Germani 2” me kapacitet të instaluar 1,500 kw.

2. Në përmbajtjen e licencës nr. 247, seria PV14K, të pasqyrohen ndryshimet respektive sipërcituar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 7, datë 17.1.2019

#### **MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë

elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 “Mbi rishikimin e ‘Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit’”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin dhjetor 2018,

konstatoi se:

- “OSHEE” sh.a., me anë të shkresës nr. 23970 prot., datë 26.12.2018, protokolluar në ERE me nr. 813 prot., datë 28.12.2018, paraqiti aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2018.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, pikërisht neni 8 i rishikuar i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- OSHEE sh.a., ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2018, si vijon:



| Çmimi për FMF i llogaritur nga OSHEE sh.a. për muajin Dhjetor 2018 |                                                                                       |                |          |
|--------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------|
| a.                                                                 | Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perpare | 9.42           | leke/kWh |
| b.                                                                 | Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje (3%)                                      | 0.28           | leke/kWh |
| c.                                                                 | Çmimi maksimal i blerjes për periudhën relevante                                      | 9.70           | leke/kWh |
| d.                                                                 | Kosto administrative e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit                             | 1.79           | leke/kWh |
| e.                                                                 | Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit                                        | 0.75           | leke/kWh |
| f.                                                                 | Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në 35 kV                               | 1.5            | leke/kWh |
| Çmimi i energjisë aktive (c+d+e+f)                                 |                                                                                       | 13.74 leke/kWh |          |

- Shoqëria “OSHEE” sh.a., bashkëlidhur këtij aplikimi, në mënyrë të përmbledhur ka paraqitur informacion mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, nga tregu i parregulluar.

- Çmimi më i lartë i realizuar për muajin dhjetor 2018, është 87.98 euro/MWh dhe është përdorur për blerjen e një sasisë prej 17,110 MWh nga shoqëria “GEN-I TIRANA” në fashën orare 6:00–24:00 në periudhën 17.12.2018–23.12.2018. Për rrjedhojë, çmimi 87.98 euro/MWh propozohet të konsiderohet për përcaktimin e çmimit për klientët FMF për muajin dhjetor.

- Praktika e ndjekur nga shoqëria “OSHEE” sh.a., për përcaktimin e “Çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike për periudhën e furnizimit”, nëpërmjet metodës të mesatares së ponderuar, bie në kundërshtim me përkufizimin e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, sipas të cilit CBE-t është çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE).

- Sipas informacionit të shoqërisë “OSHEE” sh.a., për realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, data 14.12.2018 është data kur kompania ofertuese GEN-I TIRANA (çmimi më i lartë) ka dalë fituese në fazën përfundimtare të negociimit. Gjykojmë që data 14.12.2018, duhet të konsiderohet për përcaktimin e kursit të këmbimit EUR/lekë sipas publikimeve në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton që kursi i këmbimit i përdorur në llogaritjen e çmimit të FMF-së, për muajin dhjetor 2018 është 1 EUR=123.41 eur/MWh.

- Për sa deklaruar nga “OSHEE” sh.a. dhe paraqitur edhe më parë, për përcaktimin e çmimit të FMF-së, shoqëria “OSHEE” sh.a. vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktiviteteve të Furnizimit dhe Shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit, si dhe kostot e disbalancave për

klientët e FMF-së. Në këto kushte është e arsyeshme të pranohet kosto për njësi prej 1,79 lekë/kWh, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) të paraqitur nga “OSHEE” sh.a.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin nr. 210, datë 28.12.2017 “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për vitin 2018” është 0.75 lekë/kWh

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin nr. 190, datë 30.8.2018 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a., për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018” është 1.5 lekë/kWh.

- Nga verifikimi i informacionit dhe përllogaritjeve të paraqitura nga “OSHEE” sh.a., rezulton se çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga FMF-ja, për muajin dhjetor 2018 është 15.22 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 15.22 lekësh/kWh për muajin dhjetor 2018.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrir Ahmeti

**VENDIM****Nr. 8, datë 17.1.2019****MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U  
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES  
ME PËRPARËSI PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; VKM-së nr. 687, datë 22 nëntor 2017, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”; nenit 15; nenit 21; nenit 22 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, lidhur me “Çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019”,

konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 687, datë 22 nëntor 2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi.

- Metodologjia për llogaritjen e këtij çmimi është: “Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) për vitin 2018 sikurse paraqitur në tabelën më sipër rezulton në vlerën 51 euro/MWh.

- Sipas VKM-së së sipërpërmendur, me normë mesatare të shkëmbimit euro/lekë të vitit të fundit

kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2018. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit lekë/EUR, për çdo ditë të vitit 2018 rezulton se kursi mesatar i këmbimit për vitin 2018 rezulton në vlerën 127.575 lekë/EUR.

- ERE rezervon të drejtën që të axhustojë llogaritjet e bëra në rast se kursi i këmbimit lekë/EUR që do të publikohet në Raportin Vjetor 2018 të Bankës së Shqipërisë (gjatë muajve në vazhdim) ndryshon nga çmimi i llogaritur deri tani.

- Nga llogaritjet e bëra, çmimi i llogaritur sipas formulës së cituar në metodologji ndodhet brenda limiteve të përcaktuar në paragrafët 2/ç dhe 2/d, të VKM-së nr. 667, datë 22.11.2017 të cilat përcaktojnë edhe kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi.

- Sipas parashikimeve të germës “d” të nenit 2 të VKM-së së sipërpërmendur, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019, do të jetë 8.4582 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019 të jetë 8.4582 lekë/kWh.

2. ERE do të korrigjojë llogaritjet e bëra në rast se kursi i këmbimit lekë/EUR që do të publikohet në Raportin Vjetor 2018 të Bankës së Shqipërisë (gjatë muajve në vazhdim) ndryshon nga çmimi i llogaritur deri tani.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë prodhuesit ekzistues me përparësi për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë